

**STATUTI**  
**I SHOQERISE "4-SEASONS COMPANY" SH.P.K**

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 9901 date dt.14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar, si dhe te gjitha legjislacionit Shqiptar ne fuqi, me vullnetin e tyre te lire, ortaket e shoqerise:

1. -**Endi KALAJA**, atesia Dilaver, lindur me 12.07.1998 ne Tirane dhe banues ne Rruga "Shefqet Kuka", Banese private nr.110, Tirane, identifikuar nga karta e identitetit nr.033212097 dhe nr. personal J80712065T;
2. -**Rei BAMI**, atesia Shyqyri, lindur me 20.06.1997 ne Tirane dhe banues ne Rruga "Ramazan Disha", Banese private nr.9, Tirane, identifikuar nga me Pashaporte nr.BJ0939995 dhe nr. personal JJ70620063Q;

Sot me daten 25.10.2023, ne Tirane, ne seline e shoqerise, hartoje dhe miratojne Statutin e Shoqerise Tregtare "**4-SEASONS COMPANY**" sh.p.k.

**KAPITULLI I**

**DISPOZITA TE PERGJITHESHME.**

**NENI 1**

**Forma, Emertimi dhe Selia e Shoqerise.**

- 1.1 Shoqeria eshte person Juridik privat dhe nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, veprimtaria e te cilit do te rregullohet nepermjet ketij statuti dhe aktit te themelimit.
- 1.2 Shoqeria do te paraqitet me emrin "**4-SEASONS COMPANY**" sh.p.k. Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjitha regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.
- 1.3 Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen: Pasuria me Certifikate nr.1383612, Njesia Administrative Dajt, Linz, Tirane.
- 1.4 Transferimi i selise se shoqerise, ne nje vend tjeter, behet me Vendim te Ortakeve.
- 1.5 Shoqeria ka te drejte te operoje me zyra, filale, dege apo agjensi ne te gjithe Territorin e Shqiperise apo jashte shtetit.
- 1.6 Zyrat filialet, deget apo agjensite, krijohen me Vendim te Ortakeve te shoqerise, te cilet organizojne punen dhe emrojne organet drejtuese dhe perfaqesuesit e tyre ligjor.
- 1.7 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj indentifikuase, ne formen dhe me ekstremitet e caktuara nga ortaket.
- 1.8 Akt themelimi dhe statute jane ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe kane karakter te deyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga Legjislacioni Shqipetar.

**NENI 2**

**Regjistrimi juridik i shoqerise.**

- 2.1 Shoqeria udhehiqet nga parimet e ekonomise se tregut dhe ka per qellim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

M. 1.

**2.2**. Ajo eshte nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar (sh.p.k). Veprimitaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit si dhe dispozitave te legjisacionit tregtar e atij civil, ne fuqi.

**2.3** Me vendim te ortakeve, Shoqeria mund te ndryshoje regjistrimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi, si dhe ne perputhje te plete me dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj, duke bere dhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.

Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

### **NENI 3**

#### **Objekti i veprimitarise se shoqerise.**

**3.1** Objekti i veprimitarise se shoqerise ne perputhje me legjisacionin tregtar aktual Shqiptar do te jete:

- Import-eksport te duhanit te paperpunuar/te perpunuar dhe e lendeve ndihmese per perpunimin e tij. Shitje te produkteve te duhanit shije nargjile, shisha, etj.
- Ofrimin e shërbimeve dhe hapje te pikave te shitjes. Hapje dhe shfrytëzim: bare, restorante, diskoteka.
- Shërbime të prodhimit te reklamave te te gjitha llojeve, studio fotografike, vidiografike, krijim webseite, marketimit digjital dhe shërbimeve të tjera mbështetëse.
- Marrjen dhe dhenien me qera te objekteve, impiante, fabrika, makineri e paisje, etj.

### **NENI 4**

#### **Kohe zgjatja e shoqerise**

**4.1** Kohezgjatja e shoqersie "**4-SEASONS COMPANY**" sh.p.k, eshte e pa kufizuar dhe fillon ne momentin e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

**4.2** Ky afat mund te ndryshohet ne cdo kohe me vendim te ortakeve.

**4.3** Shoqeria mund te prishet ne cdo moment me vendim te ortakeve.

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

### **NENI 5**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 leke (njemilion mijë) leke dhe perbehet nga numeri i pjeseve 1000 dhe me vlore nominale 1.000 leke, secila pjesa.

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

### **NENI 6**

*le /*

*R. S.*

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortaku duhet ta ushtroje brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortaku tjeter te shoqerise.

#### NENI 7

Kapitali i shoqerise perbehet, nga kapitali fillestar plus shtesen e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajteshme ose te palujteshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

#### NENI 8

Kuotat e kapitalit jane te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarise te shoqerise.

#### NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi, nuk e cliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton dhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

#### NENI 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve ne proporcion me perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortaket nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar ne ligj .

#### NENI 11

Shoqeria tragtare "**4-SEASONS COMPANY**" sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurive se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria tregtare "**4-SEASONS COMPANY**" sh.p.k. gezon te drejta sikunder çdo person tjeter juridik, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### NENI 12

Shoqeria tragtare "**4-SEASONS COMPANY**" sh.p.k. vepron ne regimin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqerise, mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk perjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet .

### KAPITULLI III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### NENI 13

#### ORGANI VENDIMARRES

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- ë) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, zmadhimin dhe zgogimin e kapitalit: pjesëtimin e kuotave dhe amulimin e tyre; e përfshirësmin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- f) organizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të amblese,
- h) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfshirës sohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i trete.

Autorizimi mund të jepet vetem per një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **NENI 14**

#### **MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

14.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të permبaje vandin, diten, oren e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo me vone se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

14.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 të këtij neni, ajo mund te marre vendime të vlefshme vetem nese te gjithë ortakët janë dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### **NENI 15**

#### **KUORUMI**

15.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne një shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte voter, ne me shume se 30 per qind te kuotave.

15.2. Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose per çeshtje te cilat kerkoj shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare" mund te merren vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më

shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

15.3.Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 16

### MARRJA E VENDIMEVE

16.1.Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

16.2.Asambleja e përgjithshme vendos me shumicen e thjeshte te votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorie
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve te ecurisë se veprimtarise;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- ë) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë:

16.3.Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## NENI 17

### PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

17.1.Ortaku nuk mund të ushtroje te drejtën e votës nese asambleja e përgjithshme merr vendim per

- a) vlerësimin e veprimtarise se tij,
- b) shuarjen e ndonjë detyrim ne ngarkim tij.
- c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqerise
- d) thenien ose jo te përfitimeve te reja

17.2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## NENI 18

### ADMINISTRATORI

18.1.Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5(pese vite) me të drejtë

ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare te Biznesit

18.2 Si administrator i parë i shoqërisë do te caktohet: **Endi KALAJA**, atesia Dilaver, lindur me 12.07.1998 ne Tirane dhe banues ne Rruga "Shefqet Kuka", Banese private nr.110, Tirane, identifikuar nga karta e identitetit nr.033212097 dhe nr. personal J80712065T;

## NENI 19

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

19.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt te dokumenteve dhe të librave kontabel te shoqërisë,
- c) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i parqet këto dokumente perpara asamblese se përgjithshme per miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe elezistencen e shoqerise;
- dh) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit.
- c) raporton përpara asamblese se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçantë për veprimtarinë e shoqerise tregtare, e kryen detyra te tjera të përcaktuara ne ligj dhe në statut.

19.2. Administratori eshte detyruar te therrase Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, te cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon te bleje nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

19.3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

19.4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohe me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

19.5.Kur administratori i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin finanziar te kompanise atehere ortaket vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij, ne fund te vtit financiare

## NENI 20

### PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

20.1.Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

20.2.Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

20.3.Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikerise, sipas neneve 14,15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te percaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin me te mire te shoqerisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarise se shoqerise ne mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara në këto dispozita; ta vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim, te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prevent apo te mundshem, te interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérbleje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividende;

c) shpérndan aktivet e shoqënisë;

d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarine tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

e) jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejte te ngrenë padi penale kunder administratorit.

Paditësit kanë të drejtë te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kerkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit të detyrës.

### **NENI 21 EVIDENCA KONTABEL, MENAXHIMI I CILESISE**

**20.1** Ne perputhje me nevojat e saj shoqeria aplikon standartet me te mira kombetare dhe nderkombetare te kontabilitetit dhe menaxhimit te cilesise. Personat perjegjes per kontabilitetin, financat dhe menaxhimin e cilesise, zgjidhen nga profesioniste te fushes nga administratori dhe perjigjen perpara tij.

**20.2** Ato mbajne perjegjesi per mimbajtjen e rregullt te te gjithe dokumentacionit te shoqerise.

**20.3** Ato perjigjen per demet qe i vijne shoqerise nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

**20.4** Ato mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

### **KREU IV MARDHENIET E PUNES NENI 22**

Mardheniet e punes ne shoqeri, rregullohen nepermjet kontratave te punes. Per cseshtjet qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitata perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### **NENI 23**

Per cdo mosmarveshje qe mund te lindin midis paleve dhe qe nuk zgjidhet me mirekuptim apo consensus, organi kopetent per zgjidhjen e saj, eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kurbin.

### **NENI 24 Sekreti i punes**

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri, jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqeria.

### **KAPITULLI V VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

#### **NENI 25 Viti finanziar**

Vitit finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Perjashtimisht viti i pare finanziar, perfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.

#### **NENI 26 Inventari dhe llogarite vjetore.**



Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.  
Ne mbylljen e vitit finanziar administratori harton inventarin e pasurise, ne kete date dhe llogarite vjetore per vitin finanziar .

### **NENI 27 Raportet vjetore**

- 27.1** Ne mbylljen e cdo viti finanziar administratori dhe eksperti kontabel (kur plotesohen kushte ligjore per mrrjen e nje eksperti), harton inventaret dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per ortaket.
- 27.2** Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit finanziar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme etj.
- 27.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emruar) miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

### **NENI 28. Rezerva e domozdoshme dhe e nevojshme.**

- 24.1** Nga fitimi i realizuar gjate vitit finanziar, pasi zbriten humbet e vitit te meparshem, hiqet me nje ane nje shume e barabarte me 5 % (peseperqind) e fitimit, e desinuar per formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domozdoshme".
- 24.2** Heqja nga fitimi per rezerven e domozdoshme, pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsyesh qfaredo, rezerva e domozdoshme ka zbritur nen 10% e kapitalit.
- 24.3** Ortaket mund te vendosin edhe zbritje te vecante ne favor te rezervave te jashtezakoneshme ose per qellime te tjera, apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

### **NENI 29**

Te ardhurat eventualisht te ndjekura nga shoqeria cdo vit finanziar jane te destinuara sic eshte vendosur nga ortaket duke i qendruar ne uljen 5 % qe do ti destinohet rerzerves ligjore.

### **KAPITULLI VI MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

### **NENI 30**

Veprimtaria e shoqerise mund te nderpritet para afatit kur shoqeria nuk rezulton rentable gjate dy vjeteve te fundit radhazi dhe kur per kete vendsos gjykata kompetente.

### **NENI 31**

- 31.1.** Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise, ortaket caktojne nje likujditor, kopetencat e tij dhe menyren e likujdimit te shoqerise, me dispozitat perkatese te ligjit tregtar. Shoqeria gjate likujdimit mban anash emertimit dhe emrin "Shoqeri ne Likujdim e siper".

**31.2.** Likujditori i emruar nga ortaket, menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise, duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjehere ortakeve.

**31.3.** Me miratimin e likujdimit shoqeria i jep fund veprimtarise.

### **NENI 32**

**32.1.** Ortaket vodosin mbi rregullshmerine e likujdimit, per te vendosur per bilancin e likujdimit dhe heqjen e mandatit te likujditorit.

**32.2.** Ortaket mund te vodosin vete realizimin e kesaj mbledhje, ne rast se likuidatori nuk e kerkon. Mbledhja vodoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose te nje mandatmbajtesi te caktuar prej tij.

### **NENI 33**

**33.1.** Kur ortaket per shkaqe te arsyeshme nuk vodosin per aktet e mesiperme, likujditori dhe cdo person i interesuar, mund te kerkoje nga Gjykata mbylljen e likujdimit.

## **DISPOZITET KALIMTARE**

### **NENI 34**

#### **Dispozitat e fundit**

**34.1.** Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuara.

**34.2.** Per efekt te inteprentimit te ketij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregatre".

**34.3.** Pavlefshmeria eventuale te dispozitave te vecanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

### **NENI 35**

#### **Gjykata kopetente.**

Gjykata kopetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit te Shoqerise eshte Gjykata e Juridikacionit te Pergjithshem Tirane.

### **NENI 36**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

## **ORTAKET**

**Endi KALAJA**

*Endi Kalaja*  
*S*

**Rei BAM**

*Rei Bami*  
*B*